



OSMANI BESON SE KOSOVA KA ENDE KOHË TA KRIJOJË QEVERINË E RE, E KRITIKON LISTËN SERBE PËR PENGESA

FAÇE 4



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, beson se vendi ka ende kohë për ta krijuar qeverinë e re gati tetë muaj pas zgjedhjeve parlamentare, por e kritikoi

partinë më të madhe të serbëve të Kosovës, Listën Serbe, se po përpiqet të sjellë pengesa në këtë drejtim. Ehat Mihtaraj, drejtor ekzekutiv i Institutit të

Kosovës për Drejtësi, beson se nëse Kushtetuesja vendos në favor të Listës Serbe, vendimi mund të ndikojë edhe në formimin e qeverisë së re

BURIM RAMADANI:
KJO JAVË ËSHTË
FINALJA: KOSOVA
NË ZGJEDHJE APO
PËRFUNDIMISHT
NË KOLAPS? F. 2



**ZGJEDHJET
LOKALE NË
MAQEDONINË E
VERIUT: KUSH
KU FITOI? F. 5**



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com


Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

AKTUALE



**BE-ja SHQYRTON TRAJNIMIN
E TRUPAVE BRENDA TERRITORIT
TË UKRAINËS F. 2**

**PËRFUNDON NUMËRIMI DHE
VERIFIKIMI I VOTAVE TË RREGULLTA
PËR ZGJEDHJET E 12 TETORIT F. 5**

**KOSOVA E PËRFOLUR NË PLANET
BELGE PËR BURGJET F. 7**

EKONOMI



**SHOIPËRIA SYNON TË OFROJË ID
DIGJITALE NË FILLIM TË VITIT 2026 F. 8**

**KOSOVA, SHTETI I VETËM
NË RAJON JASHTË CEMT-IT,
ANËTARËSIMI ËSHTË I DOMOS-
DOSHËM PËR TRANSPORTUESIT
E MALLRAVE NË BE F. 8**

SPORT



**PRISHTINA VAZHDON SERINË E
FITOREVE, BALLKANI RIKTHEHET
TE FITORJA F. 11**

Zelensky i gatshëm të takohet me Trumpin dhe Putinin në Budapest

KIEV, 20 TETOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky ka thënë se është i gatshëm të shkojë në Budapest për të diskutuar për paqe, ndonëse ka shprehur dyshime rreth gatishmërisë së presidentit rus, Vladimir Putin për t'i dhënë fund luftës që ka nisur mbi tre vjet më parë. “Nuk jam i sigurt që Putini është gati t'i japë fund luftës. Mendoj se ai dëshiron ta vazhdojë agresionin”, ka thënë Zelensky në një intervistë për

rretin televiziv “NBC”. Presidenti ukrainas ka thënë se beson që Putini preferon shtyrjen e “negociatave të vërteta për paqe” dhe heziton ta takojë atë, sepse kjo do të nënkuptonte që palët do të duhej të pajtoheshin për pozicione specifike dhe koncesione potenciale për t'i dhënë fund luftës. Zelensky ka bërë thirrje për rritje të presionit ndaj liderit rus, duke thënë se Putini “frikësohet nga

sanksionet” dhe që sanksionet sekondare do ta gjunjëzonin ekonominë ruse. Ai i ka bërë këto komente pasi presidenti amerikan, Donald Trump e ka mirëpritur Zelenskyn në Uashington më 17 tetor për të diskutuar për negociatat e së ardhmes për paqe. Zelensky është nisur në Shtëpinë e Bardhë – për herë të tretë këtë vit – me idenë se do të diskutojë ndonjë marrëveshje për armët, që parasheh furnizimin e

ushtrisë amerikane me dronë ukrainas, në këmbim të raketave me rreze të gjatë “Tomahawk”, mirëpo Trumpi ka qenë i ftohur ndaj një pakti të tillë. Presidenti amerikan u ka bërë thirrje Rusisë dhe Ukrainës që menjëherë t'i ndalin luftimet, duke thënë se mjaftueshëm gjak është derdhur, dhe i ka bërë të ditura planet për të takuar presidentin rus, Vladimir Putin në Budapest, në javët në vijim.



Data e saktë e samitit nuk është bërë ende publike. Përgjatë intervistës me “NBC”, Zelensky e ka përsëritur se është i hapur që të angazhohet në bisedime dypalëshe apo trepalëshe për paqe me Shtetet e Bashkuara dhe Rusinë në tavolinën e negociatave.

BE-JA SHQYRTON TRAJNIMIN E TRUPAVE BRENDË TERRITORIT TË UKRAINËS

BRUKSEL, 20 TETOR - Bashkimi Evropian (BE) është afër ta ofrojë trajnimin e trupave ukrainase brenda Ukrainës dhe t'i zgjerojë format e tjera të mbështetjes, përfshirë monitorimin e kufijve, ndihmën për veteranët e luftës dhe forcimin e sigurisë kibernetike të Ukrainës. Brukseli është duke shqyrtuar krijimin e pozicioneve në Ukrainë në rast të një armëpushimi në të ardhmen. Kështu është thënë sipas rishikimeve strategjike, që i ka parë “Radio Evropa e Lirë”, të dy misioneve të BE-së që merren me Ukrainën: Misioni Këshillues i BE-së (EUAM) që fokusohet në forcimin e sigurisë të sektorit civil, dhe Misioni i BE-së për Mbështetje Ushtarake (EUMAM), që deri më tani ka trajnuar 80 000 ushtarë ukrainas në territorin e BE-së. Këto rishikime vijnë në kohën kur BE-ja ende po punon lidhur me atë se çfarë garancish të sigurisë mund t'i ofrojë Kievit në rast se ndalet lufta. Në dokumente është thënë se Rusia “vazhdon ta ketë objektiv të saj riformësimin e rendit të sigurisë evropiane” dhe se “agresioni ushtarak dhe qasja e Moskës ndaj procesit diplomatik tregojnë se qëllimi i saj përfundimtar për ta nënshtruar Ukrainën nuk ka ndryshuar”. Dislokimi i trupave në Ukrainë, që nga shumë vende

konsiderohet si garancia më e madhe e sigurisë – mbetet një vendim i secilit shtet, por misionet trajnuese të BE-së i mundësojnë Brukselit që t'i ofrojë Kievit mbështetje të gjerë. Ndryshimi i mandatit të EUMAM-it dhe EUAM-it kërkon unanimitet, megjithatë në dy dokumentet thuhet se ky unanimitet po kërkohet.

Histori suksesi

EUMAM, mision që është lansuar në fund të vitit 2022 si përgjigje e drejtpërdrejtë ndaj pushtimit rus të Ukrainës, ka qenë një nga historitë e suksesit të BE-së sa i përket mbështetjes për Ukrainën. Pesëmbëdhjetë brigada luftarake janë trajnuar në 18 shtetet anëtare të BE-së, duke ofruar 1 750 module të ndryshme trajnimi, përfshirë stërvitje me avionët “F-16” dhe “Mirage”, të gjitha këto janë kryer me një buxhet relativisht modest prej 360 milionë eurosh. Kiev, megjithatë, vazhdimisht ka bërë thirrje që disa nga trajnimet të mbahen në tokën ukrainase. Po ashtu, Ukraina synon që të rrisë numrin e ushtarëve të trajnuar nga 4 000 deri në 20 000 në muaj. Në rishikimin strategjik të EUMAM-i është thënë se tri qendra trajnuese veçse janë ngritur në pjesën perëndimore të Ukrainës, por asnjëra prej tyre



nuk është plotësisht operacionale për shkak të mungesës së infrastrukturës adekuate dhe trajnerëve të kualifikuar nga jashtë. Në tekst përmenden disa mangësi për shkak të mungesës së pranisë së misionit të BE-së në terren në Ukrainë, siç janë barra logjistike dhe rreziku që trupat ukrainase duhet të ndërmarrin për të udhëtuar larg vijës së frontit për t'u trajnuar. Po ashtu, në dokument është thënë se “trajnimi në territorin e BE-së, në një mjedis paqësor, e pengon përdorimin e sistemeve UAV (fluturakeve pa pilot, të njohura edhe si dronë) dhe pajisjeve luftarake elektronike, që janë përdorur gjerësisht në këtë konflikt”. Aty është thënë se ekziston rreziku që trupat që nuk janë të BE-së të shkojnë në Ukrainë për të ofruar trajnime, nëse Brukseli heziton. Megjithatë, në dokument është

thënë se zhvendosja e disa ose të gjitha pjesëve të EUMAM-it në Ukrainë do të “nënkuptonte që një armëpushim ose ndonjë formë e marrëveshjes së përkohshme duhet të jetë në fuqi”. Po ashtu, në tekst shkruan se dislokimi duhet të “koordinohet me një kontribut të ShBA-së ose një mbështetje nga ana e saj për garancitë e sigurisë”. Për të mundësuar një dislokim të shpejtë në Ukrainë, që në fakt do të nënkuptonte një ndryshim në mandatin e misionit – rishikimi strategjik propozon një proces me dy hapa: së pari, të bihet dakord për drejtimin e ri strategjik dhe të rishikohet plani i misionit tani dhe së dyti të votohen dhe miratohen ndryshimet e nevojshme sapo kushtet në terren të lejojnë.

Përgatitja e Ukrainës për anëtarësim në BE

Teksa EUMAM-i është një mision relativisht i ri dhe nuk është i pranishëm brenda Ukrainës, EUAM-i ka qenë i vendosur në disa qytete ukrainase që pas “Revolucionit të Dinjitetit” më 2014, që solli në pushtet në Kiev forcat proevropiane pas rrëzimit të presidentit prorus, Viktor Yanukovych. Ky mision ka vazhduar të qëndrojë në Ukrainë edhe pas nisjes së pushtimit,

edhe pse ka qenë i detyruar të largohet nga zyrrat në Harkiv dhe Mariupol për shkak të luftës. Afër 400 anëtarë të misionit aktualisht punojnë së bashku me pjesëtarët e sektorëve civilë të sigurisë, sikurse Policia, Garda Kombëtare, zyra e Prokurorit të Shtetit dhe Rojet shtetërore të Kufirit. Qëllimi kryesor mbetet ende që të punohet në reformimin e këtyre institucioneve në mënyrë që ato të kenë standardet e njëjta me të BE-së sa i përket mbikëqyrjes civile dhe qeverisjes, me qëllim përgatitjen e vendit për anëtarësim eventual në bllokun evropian. Por, rishikimi strategjik i EUAM-it po ashtu sugjeron fusha të reja për misionin, sikurse mbështetja e aftësisë së Ukrainës për të monitoruar kufijtë e saj me Rusinë dhe Bjellorusinë, si dhe të jetë i pranishëm në çdo linjë kontakti në të ardhmen, në rast të një armëpushimi. Ide të tjera të reja, bazuar në nevojat dhe kërkesat e Kievit, përfshijnë ndihmë në sigurinë kibernetike dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike. Sipas dokumentit, gjatë vitit të kaluar janë ndaluar gati 600 persona të lidhur me Rusinë për aktivitete subversive në Ukrainë. Brukseli ka treguar gatishmëri për të ndihmuar në riintegrimin e veteranëve të luftës në sektorët e sigurisë civile dhe mbrojtjes civile.

Ndërron jetë Nebojsa Pavkoviq, i dënuar për krime lufte në Kosovë

PRISHTINË, 20 TETOR - Ish-gjenerali i Ushtrisë së Jugosllavisë dhe i dënuari i Hagës, Nebojsa Pavkoviq, ka vdekur në moshën 79-vjeçare në Beograd, raporton “Radio Televizioni i Serbisë”. Pavkoviq, si komandant i Armatës së Tretë të Ushtrisë jugosllave, u dënua nga Tribunali i Hagës me 22 vjet burg për krime lufte kundër shqiptarëve në Kosovë në vitin 1999. Ai e ka vuajtur dënimin në një burg në Finlandë. Me kërkesë të Qeverisë së Serbisë,

Pavkoviq është liruar para kohe më 28 shtator, për shkak të shëndetit të tij të dobët. Trajtimin, pastaj, ai e ka vazhduar në Akademinë Ushtarake Mjekësore në Beograd. Nga viti 2000 deri më 2002, Pavkoviq ka shërbyer si shef i shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë jugosllave. Më 1999, gjatë bombardimeve të NATO-s në Republikën e atëhershme Federale të Jugosllavisë, ai ishte komandant i Armatës së Tretë të Ushtrisë

jugosllave. Në vitin 2009 ishte shpallur fajtor në Hagë për të gjitha akuzat që e ngarkonin: dëbime, zhvendosje të detyruara, vrasje dhe persekutime të civilëve shqiptarë nga Kosova, në gjysmën e parë të vitit 1999. Vendimi i shkallës së parë është konfirmuar në vitin 2014. Në maj të vitit 2022, Mekanizmi Ndërkombëtar në Hagë e ka hedhur poshtë kërkesën e Pavkoviqit për lirim të parakohshëm, për shkak të

“peshës së madhe të krimeve të tij” dhe “mungesës së rehabilitimit”. Aktakuza kundër tij dhe gjeneralëve të tjerë u ngrit në fund të vitit 2003, dhe në vitin 2005 ai ishte ekstraduar në Gjykatën Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë në Hagë. Së bashku me të ishin dënuar edhe ish-shefi i shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë jugosllave, Dragolub Ojdaniq, ish-komandanti i Korpusit të Prishtinës, Vladimir



Llazareviq, gjenerali i policisë, Sreten Llukiq, dhe ish-zëvendëskryeministri i Republikës Federale të Jugosllavisë, Nikolla Shainoviq. Pavkoviq dhe Llukiq ishin dënuar me nga 22 vjet burg secili, ndërsa Ojdaniq dhe Llukiq me nga 15 vjet secili.

Jashari falënderon Hargreavesin për mbështetjen që Britania i ka dhënë FSK-së në zhvillimin e saj

PRISHTINË, 20 TETOR - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Bashkim Jashari, ka takuar ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves. Fillimisht gjeneral Jashari e falënderoi ambasadorin Hargreaves për kontributin në përkushtimin dhe mbështetjen strategjike të treguar për

zhvillimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për zhvillimin e deritanishëm të FSK-së, planifikimet për të ardhmen si dhe për synimet e avancimin e marrëdhënieve bilaterale ushtarake ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar dhe Kosovës. Në fund të takimit ambasadori

Hargreaves falënderoi gjeneral Jasharin për profesionalizmin e treguar në udhëheqjen e FSK-së. Kurse gjeneral Jashari falënderoi ambasadorin Hargreaves për mbështetjen e vazhdueshme që Mbretëria e Bashkuar ka dhënë në zhvillimin dhe avancimin e FSK-së gjatë të gjitha fazave të ngritjes së saj.



ZGJEDHJET LOKALE NË MAQEDONINË E VERIUT: KUSH KU FITOI?



SHKUP, 20 TETOR - Partia në pushtet, VMRO-DPMNE, shpalli fitore bindëse pas raundit të parë të zgjedhjeve lokale në Maqedoninë e Veriut, më 19 tetor. Partia do të ketë kryetarë komunash në 30 nga gjithsej 80 komuna, dhe pret që në raundin e dytë të fitojë edhe në rreth 20 të tjera, përfshirë edhe qytetin e Shkupit, ku kandidati i saj, Orce Gjorgjievski, është në epërsi të madhe. “Premtuam fitore, kemi fitore”, deklaroi kryeministri dhe lideri i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickoski. Ai tha se është i

kënaqur, pasi numri i përgjithshëm i votave të fituara është më i madh se në zgjedhjet parlamentare dhe ato lokale të mëparshme. Mickoski, gjithashtu, konfirmoi se nuk ka ndër mend të shkojë në zgjedhje të parakohshme parlamentare pavarësisht insistimit të opozitës nga BDI dhe theksoi se “politikat e etnocentrizmit janë mposhtur”. Opozitarja LSDM pësoi edhe një humbje pas zgjedhjeve të vitit të kaluar - atyre parlamentare dhe presidenciale. Megjithatë, partia vlerësoi se rezultati nuk është i

keq, pasi këtë herë ka fituar më shumë vota në disa komuna dhe theksoi se ka pasur “shkelje të shumta” gjatë procesit të votimit. LSDM do të ketë kryetarë komunash në Kriva Pallankë, Bogdanc dhe Krivogashtan, ndërsa pret të kalojë në raundin e dytë në rreth njëzet komuna të tjera. “Kjo është dëshmi për konsolidimin brenda partisë që ka filluar dhe do ta vazhdojmë”, ka deklaruar lideri i LSDM-së, Venko Filipçe, i cili tha se nuk ka ndër mend të japë dorëheqje pas këtyre rezultateve zgjedhore.

VLEN fitoi në Çair dhe Tetovë, ndërsa BDI në Gostivar

Në bllokun politik shqiptar, kandidati i VLEN, Izet Mexhiti, fitoi bindshëm në komunën kyçe - Çair, ndërsa Bilal Kasami në Tetovë. Në raundin e parë koalicioni fitoi edhe në katër komuna të tjera. Për Mexhitin ky do të jetë mandati i tij i katërt si kryetar komune dhe ai do të duhet ta lërë postin aktual të ministrit pasi mundi ish-ministrin e BDI-së, Bujar Osmanin, i cili ia uroi fitoren. Anëtarë dhe simpatizantë të

VLEN-it e festuan, siç thanë ata, “fitoren bindëse në Çair dhe Tetovë” pranë monumentit të Skënderbeut në Çarshinë e Vjetër. Koalicioni Aleanca Kombëtare për Integrim (AKI), i udhëhequr nga BDI, fitoi zgjedhjet për kryetarë komunash në Gostivar, Likovë, Çashkë dhe Plasnicë që në raundin e parë, njoftoi nënkryetari i BDI-së, Arbër Ademi. Ai tha se, në nivel kombëtar, “AKI është fituese absolute me mbi 20 000 vota epërsi, dhe me votat që ende po përpunohen, kjo diferencë mund të jetë edhe më e madhe”. Dita e zgjedhjeve kaloi e qetë dhe pa shkelje të mëdha. Pritshmëritë e qytetarëve janë të ngjashme - një jetë më e mirë në komuna më funksionale. Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve njoftoi se deri në orën 18:30 pjesëmarrja e votuesve ishte 46,48 për qind, që është afër nivelit të rundit të parë të zgjedhjeve të mëparshme, kur kishte arritur 51,44 për qind. Sipas listës zgjedhore, të drejtë vote kishin 1 832 415 qytetarë. Për 81 poste të kryetarëve të komunave garuan 309 kandidatë, ndërsa për vendet në këshillat komunalë konkurruan mbi 10 490 kandidatë nga gjithsej 576 lista. Një veçori e këtyre zgjedhjeve është se meshkujt dominojnë në garën për kryetar komune - 277 kandidatë ose 89,64 %, ndërsa gratë janë vetëm 32, që përfaqëson 10,36 % të numrit të përgjithshëm. Buxheti i përgjithshëm që shteti ndau për organizimin e këtyre zgjedhjeve lokale është 9 milionë e 760 mijë euro, nga të cilat dy të tretat janë mjete të destinuara për mediet dhe reklamat politike të paguara. Raundi i dytë i zgjedhjeve është caktuar për 2 nëntor.

Abdixhiku thotë se në raundin e dytë LDK-ja do të mobilizohet

PRISHTINË, 20 TETOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka pasur të hënën një takim pune me kandidatët e LDK-së që garojnë në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale. Në këtë takim u diskutuan përgatitjet e LDK-së për balotazhin dhe mobilizimi i plotë i strukturave në terren. Abdixhiku vlerësoi lart entuziazmin dhe energjinë pozitive që po mbizotëron në

çdo komunë ku LDK-ja garon, duke theksuar se qytetarët e Kosovës tashmë po e njohin qartë dallimin mes qeverisjes serioze dhe asaj të gabuar. “LDK ka dëshmuar se di të qeverisë me përgjegjësi, me ndershmëri dhe me rezultate. Kemi sjellë zhvillim, mirëqenie dhe stabilitet në komunat tona, dhe do të vazhdojmë ta bëjmë këtë me përkushtim edhe pas 9 nëntorit. LDK-ja vazhdon të

mbetet shembull i qeverisjes lokale që punon për qytetarin, për projekte konkrete, për shërbime më të mira dhe për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. LDK-ja është e bindur se me këtë frymë uniteti, profesionalizmi dhe përkushtimi të përbashkët, do të dalë fituese në shumicën e komunave në balotazh”, është thënë në komunikatën e LDK-së.





OSMANI BESON SE KOSOVA KA ENDE KOHË TA KRIJOJË QEVERINË E RE, E KRITIKON LISTËN SERBE PËR PENGESA

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, beson se vendi ka ende kohë për ta krijuar qeverinë e re gati tetë muaj pas zgjedhjeve parlamentare, por e kritikoi partinë më të madhe të serbëve të Kosovës, Listën Serbe, se po përpiqet të sjellë pengesa në këtë drejtim. Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, beson se nëse Kushtetuesja vendos në favor të Listës Serbe, vendimi mund të ndikojë edhe në formimin e qeverisë së re

PRISHTINË, 20 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, beson se vendi ka ende kohë për ta krijuar qeverinë e re gati tetë muaj pas zgjedhjeve parlamentare, por e kritikoi partinë më të madhe të serbëve të Kosovës, Listën Serbe, se po përpiqet të sjellë pengesa në këtë drejtim. Osmani tha se është në interes të Kosovës ta ketë sa më parë një qeveri të re dhe me mandat të plotë kushtetues. “Unë nuk do të ngutesha që të jap supozime se do të dështojë krijimi i qeverisë, ka edhe pak kohë”, tha Osmani për gazetarë pas një ngjarjeje të

organizuar të hënën në kuadër të Muajit Ndërkombëtar të Luftës Kundër Kancerit të Gjirit në Prishtinë. Përpjekjet për krijimin e qeverisë së re nisën më herët këtë muaj, pasi u konstitua Kuvendi i ri më 10 tetor, duke i dhënë fund një ngërçi disamujor pas zgjedhjeve të 9 shkurtit. Një ditë pas konstituimit të Kuvendit, presidentja Osmani mandatoi kryetarin e Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, për formimin e qeverisë së re.

Por, kushtetutshmëria e konstituimit të Kuvendit të ri është kontestuar nga Lista Serbe - e cila gëzon mbështetjen e Beogradit - pasi ajo nisi ankesë në Gjykatën Kushtetuese të vendit për zgjedhjen e nënkryetarit serb të Kuvendit. Ajo e ka kundërshtuar zgjedhjen e Nenad Rashiqit nënkryetar, duke pretenduar se janë bërë shkelje kushtetuese dhe të rregulloreve të punës së Kuvendit. Në ankesën e saj, Lista Serbe kërkoi që gjykata të vendosë një masë të përkohshme për të ndaluar, siç tha, “veprimet antikushtetuese që mund të shkaktojnë dëme të pakthyeshme”. Gjykata më e lartë e vendit ende nuk ka vendosur rreth ankesës së Listës Serbe, por ka konfirmuar se e ka pranuar atë. Kjo është hera e dytë që Lista Serbe ankohet në Kushtetuese për çështjen e nënkryetarit serb në muajt e fundit, pasi në gusht ishte ankuar kundër votimit ndaras. Osmani tha se “vonesa që po

tentohet të krijohet nga Lista Serbe i dëmton interesat jo vetëm të Kosovës si shtet, por të të gjithë qytetarëve, përfshirë edhe serbët”. Ehat Miftaraj, drejtor ekzekutiv i Institutit të Kosovës për Drejtësi, beson se nëse Kushtetuesja vendos në favor të Listës Serbe, vendimi mund të ndikojë edhe në formimin e qeverisë së re. “Me të do të binte poshtë nominimi dhe mandati i Lëvizjes Vetëvendosje nga presidentja për kryeministrin e ardhshëm të Kosovës”, vlerëson Miftaraj. Kurti u nominua më 11 tetor dhe ai ka tani edhe gjashtë ditë kohë t’ia paraqesë Kuvendit të Kosovës përbërjen dhe programin e qeverisë për miratim, sipas ligjit. Por, ai do të ketë punë për t’i gjetur të paktën 61 vota në Kuvendin me 120 deputetë për mandatin e tretë në krye të qeverisë, pasi partia e tij i fitoi 48 ulëse në zgjedhjet e 9 shkurtit. Nënkryetarja e Kuvendit të Kosovës, Albulena Haxhiu nga partia e Kurtit, tha ditë më parë se partia e saj mund të bisedojë me

Lidhjen Demokratike të Kosovës, e cila ka 20 ulëse, për ndonjë koalicion të mundshëm, pasi Nisma Socialdemokrate, që ka tri ulëse, nuk ka qenë e interesuar të përfshihet në qeverisje. Ajo e ka përjashtuar ndonjë koalicion të mundshëm me Partinë Demokratike të Kosovës, e cila doli e dyta me 24 ulëse, dhe Listën Serbe - partinë më të madhe të serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit. Haxhiu ka përmendur mundësinë që të diskutojnë me deputetët individualë për votimin e Qeverisë së re të Kosovës. Në rast se LV-ja nuk arrin t’i mbledhë 61 vota, presidentja Osmani ka detyrën brenda dhjetë ditësh t’i ftojë partitë për konsultime dhe të vendosë për mandatarin që ka shanset më të mëdha për ta formuar qeverinë. Nëse as pas përpjekjes së dytë qeveria nuk mund të formohet, presidentja Osmani, sipas Kushtetutës, duhet të shpallë zgjedhje të reja, që duhet të mbahen brenda 40 ditësh.

Burim Ramadani: Kjo javë është finalja: Kosova në zgjedhje apo përfundimisht në kolaps?

PRISHTINË, 20 TETOR - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Burim Ramadani, ka thënë se të dielën e ardhshme, më 26 tetor, është dita e fundit kur mund të votohet për ose kundër qeverisë Kurti 3. “Kjo javë është finalja: Kosova në zgjedhje apo përfundimisht në kolaps?”, ka shkruar Ramadani në “Facebook”. Ai ka thënë se, sipas fakteve publike të deritashme, nuk ka

shumicë parlamentare as nga “Qeveria në detyrë” dhe as nga “Opozita në detyrë”. Kështu që, sipas tij, përcaktohet nëse Kosova po shkon në zgjedhje të parakohshme parlamentare. “Prandaj, i bie që zgjedhjet parlamentare të mbahen më 14 dhjetor! Këtë skenar të ngjarjes mund ta ndryshojë vetëm mundësia që Gjykata Kushtetuese të vendos Masë të Përkohshme rreth procedurës së

konstituimit të Kuvendit. Në atë rast, zgjedhja e Qeverisë apo shpallja e zgjedhjeve pamundësohet për të paktën rreth një muaj. Kështu, Kosova hyn në dhjetor pa Qeveri dhe pa Parlament. Rrjedhimisht, zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen para fundit shkurtit 2026. Pra, Kosova hyn në tehun e kolapsit politik, institucional dhe buxhetor”, ka shkruar Ramadani.



LDK-ja KUNDËR KOALICIONIT TË XHAFER TAHIRIT ME LV-në NË VUSHTRRI

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 20 TETOR - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka njoftuar se nuk ka autorizuar dhe nuk do të autorizojë asnjë koalicion lokal. Ky reagim i partisë vjen pas nënshkrimit të marrëveshjes së koalicionit mes kandidatit të saj për komunën e Vushtrrisë, Xhafer Tahirit, dhe kandidatit të Lëvizjes Vetëvendosje, Sylejman Meholli.

LDK-ja këtë veprim e ka quajtur "individual, të papranueshëm dhe në kundërshtim me procedurat" e kësaj partie. "Veprimet e kandidatit tonë në Vushtri për të lidhur koalicion me një parti

tjetër, janë veprime individuale, të papranueshme dhe në kundërshtim me procedurat statutare të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Veprimet e tjera, sikurse ky i sotmi, janë pa ndonjë vlerë dhe në kundërshtim me praktikën demokratike të LDK-së. Si të tilla, ato do të marrin trajtim procedural sipas statutit pas përfundimit të garës lokale. LDK-ja tani është e fokusuar në garën e saj elektorale të balotazhit dhe jo në garën e partive tjera", thuhet në reagimin e LDK-së.

Në komunën e Vushtrrisë më së shumti vota ka arritur të sigurojë Ferit Idrizi nga Partia Demokratike e Kosovës, me 45.56 % ose 13 526 vota. Pas tij,

i dyti është Sylejman Meholli me 30.63 % ose 9 093 vota. Më pas vjen Xhafer Tahiri nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me 19.72 % ose 5 854 vota.

Të hënën kandidati i LDK-së, Xhafer Tahiri dhe kandidati i LV-së, Sylejman Meholli, kanë nënshkruar marrëveshje për një koalicion paszgjedhor.

Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, në fjalimin e tij i ka uruar të dy kandidatët për këtë koalicion. "Le të punojmë çdo ditë e çdo orë që këtë marrëveshje për bashkëqeverisje ta realizojmë me kryetarin Sylejman Meholli dhe me drejtorët që do të bëjnë punë të mira për të gjithë qytetarët e Vushtrrisë", ka thënë



Kurti para të pranishmëve. Kjo marrëveshje është nënshkruar në Kalanë e

Vushtrrisë. Balotazhi për zgjedhjet lokale në Kosovë do të mbahet më 9 nëntor.

PËRFUNDON NUMËRIMI DHE VERIFIKIMI I VOTAVE TË RREGULLTA PËR ZGJEDHJET E 12 TETORIT

Prishtinë, 20 tetor - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njoftoi se kanë përfunduar aktivitetet në Qendrat Komunale të Numërimit për zgjedhjet lokale të 12 tetorit. Ndërkaq, për ditën e tretë me radhë në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve po vazhdon numërimi i votave me postë.

Komunat e fundit në të cilat përfundoi procesi i numërimit dhe verifikimit të rezultateve në orët e vona të së shtunës ishin Prishtina, Prizreni, Gjilani dhe Malisheva.

KQZ njoftoi se sa i përket votimit brenda vendit janë verifikuar rezultatet për 2 571 vendvotime të rregullta nga zgjedhjet për kryetarë të



komunave dhe rezultatet për subjektet politike nga zgjedhjet për kuvende komunale nga 2

571 vendvotime. "Nga po kaq vendvotime, 2 571, janë numëruar votat e kandidatëve

nga zgjedhjet për kuvendet komunale. Pra, në këtë proces, në QKN, janë procesuar 5 142 kuti votime që u takojnë dy llojeve të zgjedhjeve", u tha në njoftim.

Aktualisht po vazhdon numërimi dhe verifikimi i votave nga jashtë dhe, sipas të dhënave, deri në orën 10:00 të së dielës janë numëruar 54 kuti me fletëvotime për kryetarët e komunave dhe 45 të tjera për kuvendet komunale.

Qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës votuan përmes postës nga 17 shtatori deri më 11 tetor. Sipas KQZ-së, ishin 33 841 pako me fletëvotime të supozuara dhe, pas verifikimit, 29 636 u aprovuan. Numërimi i

këtyre votave ka nisur më 17 tetor.

Pas përfundimit të numërimit të këtyre fletëvotimeve do të numërohen edhe votat me kusht dhe të personave me nevoja të veçanta dhe më pas KQZ-ja do ta shpallë rezultatin për raundin e parë të zgjedhjeve lokale.

Raundi i dytë pritet të mbahet më 9 nëntor. Sipas rezultateve preliminare, 21 komuna kanë zgjedhur në raundin e parë kryetarët e komunave, ndërkaq në 17 të tjera pritet të organizohet raundi i balotazhit. Në ditën e zgjedhjeve votuan 39.58 për qind e mbi dy milionë qytetarëve me të drejtë vote brenda vendit.

SHOQËRIA CIVILE KËRKON HEQJEN E PLOTË TË MASAVE TË BE-SË NDAJ KOSOVËS

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 20 TETOR - Shoqëria civile i është drejtuar Bashkimit Evropian me një letër përmes së cilës ka kërkuar largimin e masave ndaj Kosovës, duke vlerësuar se tani është koha e përshtatshme dhe e domosdoshme që të gjitha këto masa të hiqen.

Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) përmes një komunikate për medie ka publikuar listën e organizatave që e kanë nënshkruar këtë letër, duke potencuar se këto masa kanë rezultuar të mos jenë as të kthyeshme, as të përkohshme. "Këto masa e kanë sfiduar, por jo thyer, frymën e besimit dhe partneritetit që e lidh Kosovën me Bashkimin Evropian dhe me idealet e tij të parimeve,

drejtësisë, solidaritetit dhe shpresës. Përtej ndikimit të tyre financiar, ato kanë dekurajuar përpjekjet për reforma, kanë kufizuar punën e shoqërisë civile dhe kanë zvogëluar ndihmën në fushat e sundimit të ligjit, shëndetësisë dhe arsimit", thuhet në komunikatë. Sipas tyre, kjo situatë vazhdon ta pengojë integrimin evropian të Kosovës, "pasi ajo mbetet i vetmi vend me orientim drejt BE-së në kontinent që ende nuk ka marrë statusin e vendit kandidat".

GLPS-ja ka theksuar se angazhimi konstruktiv dhe i balancuar i Bashkimit Evropian mbetet jetik për ruajtjen e këtij përparimi dhe për mbështetjen e stabilitetit për të gjithë komunitetet. "Pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në zgjedhjet e fundit lokale është një hap

pozitiv drejt rikthimit të përfaqësimit dhe legjitimitetit. Sulmi i dhunshëm terrorist në Banjskë dhe ngritja e aktakuzës ndaj përgjegjësve shënuan një moment të rëndësishëm në përballjen me strukturat kriminale në veri. Këto zhvillime, edhe pse të brishta, nënvizojnë se llogaridhënia dhe dialogu janë thelbësorë për siguri dhe bashkëpunim afatgjatë".

Ndërsa kanë shprehur mirënjohje që në maj të vitit 2025, Bashkimi Evropian ka nisur tërheqjen graduale të masave ndaj Kosovës. "Ne besojmë se rrethanat që fillimisht çuan në vendosjen e këtyre masave tashmë kanë pushuar së ekzistuari. Në dritën e themelimit të institucioneve të reja në nivel lokal, tërheqja e masave do të



përcillte një mesazh pozitiv bashkëpunimi ndërmjet BE-së dhe Kosovës dhe do ta forconte më tej besueshmërinë e Bashkimit dhe angazhimin e tij në rajon".

BE-ja ka vendosur disa masa ndëshkuese ndaj Kosovës në vitin 2023 për shkak të rritjes së

tensioneve në veriun e territorit të banuar me shumicë serbe. Megjithatë, pavarësisht prej thirrjeve të autoriteteve të Kosovës për largimin e tyre, dhe rekomandimeve të ligjvënësve e diplomatëve evropianë, shtetet anëtare akoma nuk janë pajtuar.

Në hapësirat e QKUK-së mbillen fidanë për një ambient më të shëndetshëm

PRISHTINË, 20 TETOR - Në hapësirat e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) u zhvillua të hënën një aktivitet simbolik i mbjelljes së fidanëve, në kuadër të nismës “30 vjet për jetën, 30 fidanë për të ardhmen - Sot mbjellim shpresë”, organizuar nga kompania “Merck” dhe partneri i saj “Varus”.

Në këtë aktivitet mori pjesë u. d. drejtori i përgjithshëm i QKUK-së, Mentor Zejnullahu, i cili i falënderoi organizatorët për këtë iniciativë të vlefshme që kontribuon jo vetëm në gjelbërimin e ambientit, por edhe në përçimin e mesazhit të kujdesit, qëndrueshmërisë dhe shpresës për jetën. “Çdo

hap për një ambient më të shëndetshëm është një hap drejt një jete më të mirë. Falënderojmë kompanitë ‘Merck’ dhe ‘Varus’ për përkushtimin dhe bashkëpunimin me QKUK-në në këtë nismë simbolike, që mbjell shpresë për të ardhmen”, u shpreh drejtori Zejnullahu.

Ky aktivitet është pjesë e angazhimeve të përbashkëta për përmirësimin e ambientit dhe promovimin e përgjegjësisë sociale në hapësirat e shëndetësisë publike. Organizatorët dhe donatorët e këtij aktiviteti shprehën lumturi për kontributin e dhënë ndër vite, duke premtuar angazhim të mëtutjeshëm.



DREJTËSIA NDËRKOMBËTARE NË HAGË: INSTRUMENT POLITIK NDAJ ÇLIRIMTARËVE TË KOSOVËS, PADITË E PUŠHTETIT TË MILLOSHEVIQIT DHE NARRATIVA RUSE



Shkruan: Prof. Dr. Fejzulla BERISHA

Lufta e Çlirimit të Kosovës (1998-1999) përbën një nga ngjarjet më vendimtare për vetëvendosjen dhe mbrojtjen e të drejtave themelore të shqiptarëve në Ballkan. Regjimi i Millosheviqit zhvilloi një politikë të dhunshme dhe sistematike, përfshirë pastrime etnike, masakra, dhunë seksuale dhe shkatërrim të pasurive private. Popullata civile shqiptare u ekspozua ndaj terrorit të regjimit, duke shkaktuar një krizë humanitare dhe një urgjencë ndërkombëtare për mbrojtje. Çlirimtarët e Kosovës, të përfaqësuar kryesisht nga

Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK), vepruan për mbrojtjen e popullatës civile dhe të të drejtës për vetëvendosje. Veprimet e tyre shpesh kanë qenë të koordinuara me standardet e së drejtës humanitare ndërkombëtare, duke synuar minimizimin e viktimave civile dhe ruajtjen e rendit gjatë konfliktit.

Analizë e aktakuzave dhe instrumentalisë politike

Aktakuzat në Hagë ndaj çlirimtarëve të Kosovës shpesh pasqyrojnë narrative të

imponuara nga pushteti serb dhe propagandë ruse. Paditë e regjimit të Millosheviqit dhe lobimet e vazhdueshme diplomatike kanë krijuar një kornizë ku veprimet e UÇK-së paraqiten jashtë kontekstit historik dhe humanitar. Ky instrumentalizim i drejtësisë për qëllime politike deformon kuptimin e aktakuzave dhe minimizon krimet e regjimit serb. Argumenti kryesor është se kur drejtësia ndërkombëtare interpretohet duke u bazuar mbi narrative politike, ajo humb objektivitetin dhe kredibilitetin e saj. Analiza e aktakuzave tregon se shpesh mungon referimi ndaj kontekstit të dhunës sistematike serbe dhe pastrimeve etnike, duke krijuar një pasqyrë të njëanshme.

Dimensioni politik dhe ndikimet ndërkombëtare

Proceset gjyqësore nuk zhvillohen në një vakum juridik; ato janë të ndikuara nga politika rajonale dhe globale. Narrative të imponuara nga Serbia dhe mbështetja propagandistike e Rusisë kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në mënyrën se si interpretohen veprimet e çlirimtarëve shqiptarë. Ky dimension politik ka pasoja të mëdha: cenon besueshmërinë e drejtësisë ndërkombëtare, ndikon në memorien historike, dhe krijon një perceptim të deformuar të historisë në publikun ndërkombëtar. Për më tepër, përdorimi i drejtësisë si instrument politik ka efekt diplomatik: ai ndikon në njohjen ndërkombëtare të Kosovës, në marrëdhëniet

rajonale dhe në procesin e pajtimit midis palëve. Kur drejtësia instrumentalizohet, ajo bëhet vegël e politikave destabilizuese dhe minon proceset e dialogut rajonal.

Krahasime ndërkombëtare dhe precedentë ligjorë

Në tribunalet ndërkombëtare për Ruandën, Sierra Leone dhe ish-Jugosllavinë, vërehet se kur ekziston interes politik, drejtësia shpesh interpretohet sipas nevojave të fuqive ndërkombëtare dhe jo vetëm sipas ligjit. Për çlirimtarët e Kosovës, kjo ka krijuar precedent shqetësues, duke cenuar integritetin dhe objektivitetin e drejtësisë ndërkombëtare dhe duke rrezikuar kredibilitetin e institucioneve ndërkombëtare.

Pasojat mbi drejtësinë dhe memorien historike

Cenimi i integritetit të drejtësisë ndërkombëtare; Shkëputja e perceptimit të drejtësisë nga publiku ndërkombëtar; Dëmtimi i moralit dhe memories historike të shqiptarëve; Rritja e tensioneve politike dhe destabilizimi i dialogut rajonal; Manipulimi i narrativeve historike për përfitime politike.

Argumentim dhe ilustrime konkrete

Shumë aktakuzë në Hagë përqendrohen në veprime të

caktuara të individëve të UÇK-së, duke i nxjerrë ato nga konteksti i përgjithshëm të luftës kundër agresionit serb. Në raportet ndërkombëtare për krimet e Millosheviqit dhe forcave serbe, evidentohet dhuna sistematike kundër civilëve shqiptarë, që shpesh minimizohet në aktakuzat ndaj çlirimtarëve. Narrative propagandistike ruse dhe serbe kanë tentuar të stigmatizojnë luftëtarët shqiptarë, duke influencuar perceptimin e aktakuzave në nivel ndërkombëtar. Për rivendosjen e besimit dhe kredibilitetit të drejtësisë ndërkombëtare, institucionet e Hagës duhet të: Sigurojnë trajtim objektiv dhe paanshëm të çdo aktakuze; Marrin parasysh kontekstin historik dhe humanitar të veprimeve të çlirimtarëve; Distancohen nga çdo ndikim politik apo propagandistik; Komunikojnë me transparencë me publikun ndërkombëtar; Respektojnë plotësisht të drejtat dhe dinjitetin e individëve të përfshirë në luftën për çlirimin e Kosovës. Vetëm një qasje e tillë mund të garantojë që drejtësia ndërkombëtare të mos përdoret si instrument politik dhe të mbrojë parimet universale të ligjit, të drejtës humanitare dhe të të drejtave të njeriut. Çlirimtarët e Kosovës meritojnë trajtim të drejtë, të paanshëm dhe të respektueshëm, në përputhje me parimet më të larta të drejtës ndërkombëtare.

Policia në Mitrovicën e Jugut mban ligjërata në shkolla për parandalimin e substancave narkotike

MITROVICË E JUGUT, 20 TETOR - Me qëllim të parandalimit dhe vetëdijesimit të nxënësve, zyrtarë policorë në kuadër të Stacionit Policor Jug në Mitrovicë, po mbajnë ligjërata me nxënës të shkollave fillore

të Mitrovicës së Jugut. Këto ligjërata kanë për synim parandalimin dhe vetëdijesimin e nxënësve për rrezikun dhe pasojat e substancave narkotike. Pjesë përbërëse e ligjëratave

është njoftimi për detyrat dhe përgjegjësitë që zbaton policia në fushën e parandalimit ashtu edhe në atë të reagimit, gjegjësisht trajtimit të rasteve të kësaj natyre si dhe për pasojat që shkakton kjo

dukuri. Angazhimet policore për ofrimin e sigurisë, këshillimit, edukimit dhe aktiviteteve të tjera parandaluese do të jenë të vazhdueshme përgjatë tërë vitit shkollor.



KOSOVA E PËRFFOLUR NË PLANET BELGE PËR BURGJET

PRISHTINË, 20 TETOR - Belgjika po shqyrton mundësinë e ndërtimit ose marrjes me qira të një burgu jashtë vendit, me Kosovën të përmendur si opsion i mundshëm. Organizatat e Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut kundërshtojnë çdo marrëveshje të tillë, duke theksuar rreziqet për sigurinë dhe barazinë mes të burgosurve. Kosova ka tashmë një marrëveshje dhjetëvjeçare me Danimarkën për të strehuar të burgosur danezë.

Belgjika po shqyrton mundësinë që të ndërtojë ose të marrë me qira një burg jashtë territorit të saj dhe mediet belge kanë përmendur Kosovën si një nga opsionet e mundshme.

Më 6 tetor, ministrja belge e Drejtësisë, Annelies Verlinden, dhe ministrja e Azilit dhe Migrimit, Anneleen Van Bossuyt, qëndruan në Kosovë, ku u takuan me presidenten Vjosa Osmani dhe me ushtruesin e detyrës së ministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu, si dhe në Shqipëri.

Në njohitimet zyrtare për medie nga këto institucione nuk është përmendur që gjatë takimeve është diskutuar për ndërtimin apo marrjen me qira të ndonjë burgu. Por, sipas burimeve të Radios Evropa e Lirë, kjo çështje është përmendur shkurtimisht nga zyrtaret belge - "pa u hapur ndonjë diskutim i detajuar nga pala kosovare".

Pas qëndrimit në dy vendet e Ballkanit Perëndimor, ministrja belge e Drejtësisë, Verlinden, shkroi në "Facebook" se vendi i saj po shqyrton "mundësinë e ndërtimit të një burgu jashtë vendit për kriminelët e paligjshëm", por nuk përmendi ndonjë shtet specifik.

Në të njëjtin postim, ajo tha se në burgjet belge ndodhen 307 shqiptarë, prej të cilëve 253 pa leje qëndrimi. "Nëse dikush dënohet këtu dhe nuk ka të

drejtë qëndrimi, mund ta vuajë dënimin në vendin e origjinës. Kjo do të thotë ekzekutim i duhur i dënimit dhe përfitim i veçantë për efikasitetin e burgjeve tona", shkroi Verlinden.

"Radio Evropa e Lirë" dërgoi email në adresë të ministrisë së saj dhe të Qeverisë së Belgjikës, me pyetjen nëse ky vend është i interesuar të ndërtojë apo marrë ndonjë burg me qira në Kosovë, por as pas një javë pritjeje nuk mori përgjigje.

Në përgjigje të pyetjes së REL-it, Ministria e Drejtësisë e Kosovës tha se, në përputhje me Ligjin për Qeverinë, qeveria e vendit - e cila është në detyrë nga fundi i marsit - nuk ka kompetenca për të miratuar nisma të reja për marrëveshje ndërkombëtare apo për të hyrë në negociata të tilla. "Sa i përket ndonjë marrëveshjeje të mundshme për ndërtimin apo marrjen me qira të një burgu në Kosovë nga shteti belge, aktualisht nuk ekziston asnjë marrëveshje e tillë, dhe as ndonjë proces formal në zhvillim", thuhet në përgjigjen e ministrisë.

"Radio Evropa e Lirë" pyeti edhe Zyrën e presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, nëse çështja e burgjeve është diskutuar gjatë takimit me zyrtaret belge.

Nga kjo zyrë thanë se "gjithçka është e sqaruar dhe ndodhet në komunikatën për medie".

Në komunikatën e publikuar më 7 tetor, zyra e presidentes nuk përmendi asgjë lidhur me ndonjë marrëveshje apo diskutim për burgjet.

Në të thuhej se gjatë takimit është biseduar për "marrëdhëniet e shkëlqyera dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Belgjikës, bashkëpunimin në fushën e drejtësisë, sigurisë, sundimit të ligjit, procesin e integritetit evropian, si dhe bashkëpunimin në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes".



Kundërshtimi i organizatave të Kosovës ndaj planit të përfolur belge

Organizatat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë thonë se janë kundër një marrëveshjeje të tillë eventuale. Sipas Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLJN), plani i përfolur i Belgjikës për të dërguar të burgosur në Kosovë paraqet rrezik për sigurinë dhe shkelje të të drejtave të njeriut.

Drejtori ekzekutiv i këtij këshilli, Behxhet Shala, thotë se një marrëveshje e tillë do t'i diskriminonte të burgosurit e Kosovës dhe do ta rrezikonte rritjen e krimit, prostitucionit dhe trafikimit me njerëz. Ai shton se Belgjika mund ta shfrytëzojë "anarkinë institucionale" në Kosovë për të imponuar një marrëveshje të ngjashme me atë të Danimarkës, ndaj së cilës është gjithashtu kritik.

Sipas tij, kjo marrëveshje ka legalizuar zbatimin paralel të dy sistemeve të ndryshme penale: atij danez - shumë të avancuar, dhe atij kosovar që është më mbrapa me standarde. Shala thotë se KMDLJN-ja - ndonëse nuk i monitoron fizikisht burgjet, për shkak të mungesës së marrëveshjes me Ministrinë e Drejtësisë - mban kontakte të rregullta telefonike me të dënuarit, avokatët dhe familjarët e tyre.

Për Mehmet Musajn nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) - organizatë që monitoron sistemin korrektues në Kosovë - marrëveshjet e tilla mund të krijojnë standarde të dyfishta mes të burgosurve vendorë dhe atyre të huaj, duke cenuar parimin e barazisë. "Është thelbësore që çdo marrëveshje e mundshme të garantojë standarde të njëjta për të gjithë,

pa dallim origjine, dhe të përfshijë mekanizma të pavarur monitorimi për respektimin e të drejtave të njeriut", thotë ai për "Radion Evropa e Lirë". Sipas tij, një marrëveshje e tillë do të kishte kuptim vetëm nëse do të siguronte respektim të plotë të të drejtave të njeriut, transparencë dhe përfitime konkrete për Kosovën, si: zhvillimi i kapaciteteve institucionale apo përmirësimi i infrastrukturës korrektuese. Si Shala ashtu edhe Musaj thotë se deri më tani nuk është kontaktuar nga ndonjë institucion i Kosovës lidhur me këtë temë. Disa medie në Shqipëri raportuan se vendi ka refuzuar kërkesën e Belgjikës për ndërtimin ose marrjen me qira të një burgu, por Ministria e Drejtësisë atje nuk e konfirmoi këtë për "Radion Evropa e Lirë".

Marrëveshja me Danimarkën dhe debatet rreth burgjeve të huaja

Kosova ka tashmë një marrëveshje dhjetëvjeçare me Danimarkën, sipas së cilës, 300 të burgosur danezë do të vendosen në burgun e Gjilanit. Kuvendi i Kosovës e ratifikoi këtë marrëveshje më 23 maj të vitit 2024, ndërsa Shërbimi danez i Burgjeve konfirmoi më herët për Radion Evropa e Lirë se transferimi i parë i të burgosurve pritet të bëhet në gjysmën e parë të vitit 2027.

Sipas marrëveshjes, të burgosurit që do të transferohen nuk do të jenë shtetas danezë dhe nuk do të kenë rrezikshmëri të lartë. Ata nuk do të jenë të dënuar për krime lufte, terrorizëm apo me çrregullime të rënda mendore. Në këmbim, Kosova do të përfitojë mbi 200 milionë euro, një pjesë e të cilave do të investohet në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ndërsa

pjesa tjetër në energji të ripërtërishme. Sipas Behxhet Shalës, dhënia me qira e burgjeve duhet të ndalet, pasi "në planin afatgjatë, këto marrëveshje do ta dëmtojnë dhe dobësojnë sistemin korrektues të Kosovës".

Ai shton se interesim më herët kanë treguar edhe Mbretëria e Bashkuar dhe Austria, ndërsa Belgjika, sipas tij, ka ndërmarrë hapa më konkretë përmes takimeve me udhëheqësit e Kosovës.

Drejtori i Shërbimit Korrektues në Kosovë, Ismail Dibrani, konfirmoi në maj të këtij viti se disa shtete evropiane kanë shprehur interesim për t'i dërguar të burgosurit e tyre në Kosovë, por se këto kërkesa janë refuzuar - pa specifikuar se për cilat shtete bëhej fjalë.

Ky institucion nuk iu përgjigj pyetjeve të "Radios Evropa e Lirë" lidhur me interesimin e mundshëm të Belgjikës për ndërtimin apo marrjen me qira të ndonjë burgu në Kosovë.

Më herët këtë vit, Kosova është pajtuar të strehojë edhe 50 migrantë nga shtete të treta që kanë qëndruar në ShBA, ndërsa ka shprehur gatishmëri për t'i strehuar edhe azilkërkuesit e refuzuar nga Mbretëria e Bashkuar.

Pas rikthimit të talibanëve në pushtet në Afganistan në vitin 2021, Kosova ka strehuar edhe rreth 1 900 shtetas afganë që janë evakuuar nga ky vend.

Njohësit e kësaj fushe thonë se marrëveshjet e tilla sjellin përfitime për Kosovën, si investime apo mbështetje specifike, por jo përparim drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian apo ndonjë organizatë tjetër. Sipas organizatave për të drejtat e njeriut, këto marrëveshje janë politike dhe rrezikojnë shkeljen e të drejtave të migrantëve apo të burgosurve.

Çfarë shkruajnë mediet belge?

Në një artikull të publikuar në uebfaqen vrt.be më 9 tetor, shkruan se dy ministret belge, Verlinden dhe Van Bossuyt, ishin në një mision në Shqipëri dhe në Kosovë për të gjetur zgjidhje për burgjet e mbipopulluara belge. Ato thanë se dëgjuan "gatishmëri nga ministrat përkatës" në të dyja vendet për t'i diskutuar mundësitë.

Në veçanti u tha se është shqyrtuar ndërtimi ose marrja me qira e një burgu në Kosovë për t'i transferuar atje personat e ndaluar ilegalisht. Sipas këtij raporti, kostoja është gjithashtu

e konsiderueshme.

Danimarka do të duhet të paguajë 200 milionë euro për infrastrukturën dhe rojet e burgut në Kosovë.

Belgjika do të preket gjithashtu ndjeshëm, megjithëse shumica e saktë ende nuk është bërë me dije.

Në këmbim të transferimit të të burgosurve, Kosova, sipas këtij raporti, do të donte mbështetje për ambiciet e saj për t'u bërë anëtare e BE-së. "Do të varet nga të gjithë ne që ta ndihmojmë Kosovën në këtë drejtim", citohet të ketë thënë Van Bossuyt.

FKEE-ja hap konkurs kombëtar për “ide të ndritshme për një të ardhme të gjelbër”

PRISHTINË, 20 TETOR - Fondi i Kosovës për Eficiencë të Energjisë (FKEE) ka lansuar konkursin kombëtar për shkollat fillore të mesme të ulëta me temën “Ide të ndritshme për një të ardhme të gjelbër”, një iniciativë që synon t’i frymëzojë nxënësit e rinj në mbarë Kosovën për të menduar në mënyrë kreative dhe të qëndrueshme për të ardhmen e energjisë. Konkursi është i hapur për

nxënësit e klasave VI-IX nga shkollat publike dhe private në gjithë vendin, përfshirë pjesëmarrës nga të gjitha komunitetet. Qëllimi i tij është ta nxisë kreativitetin, mendimin kritik dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e eficiencës së energjisë (EE) dhe përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE). Konkursi përfshin tri kategori: ese - “Një e nesërme më e gjelbër - Vizioni im për eficiencën e

energjisë dhe energjinë e ripërtëritshme”, vepër artistike: “Energjia për të ardhmen - Një shprehje krijuese” dhe instalacion kreativ: “Shpikja ime e qëndrueshme”. Afati për dorëzimin e punimeve është 20 nëntor 2025, ndërsa fituesit do të shpallen në një ngjarje të veçantë. Fituesit e tre vendeve të para në secilën kategori do të shpërblehen me nga një pajisje tablet. Punimet do të vlerësohen

nga një juri profesionale, e përbërë nga përfaqësues të FKEE-së, artistë, gazetarë dhe ekspertë të fushës së energjisë dhe mjedisit. FKEE-ja ka theksuar se ky konkurs është pjesë e misionit institucional për ta promovuar kulturën e kursimit të energjisë dhe përdorimin e burimeve të qëndrueshme në të gjitha nivelet e shoqërisë. Për më shumë informata mbi konkursin,



kriteret e pjesëmarrjes dhe mënyrën e aplikimit, ju ftojmë ta vizitoni faqen zyrtare të FKEE-së: www.fkee-rks.net.

KOSOVA, SHTETI I VETËM NË RAJON JASHTË CEMENT-IT, ANËTARËSIMI ËSHTË I DOMOSDOSHËM PËR TRANSPORTUESIT E MALLRAVE NË BE

PRISHTINË, 20 TETOR - Kosova, ndryshe nga vendet e tjera të rajonit si Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnjë-Hercegovina, ende nuk është bërë anëtare e Konferencës Evropiane të Ministrave të Transportit e quajtur CEMENT. Mosanëtarësimi në këtë mekanizëm evropian është duke kufizuar mundësitë e transportuesve me mallra të Kosovës në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE). CEMENT-i është një marrëveshje multilaterale e cila u mundëson kompanive transportin e mallrave në vendet evropiane drejt një destinacioni të caktuar apo kalimin transit nëpër një apo më shumë shtete anëtare të CEMENT-it. Kjo certifikatë ndryshe njihet edhe si leje kalimi-ndërkombëtar dhe ka rëndësi të veçantë edhe për mbrojtjen e ambientit. Nga Shoqata e Transportit të Mallrave të Kosovës kanë thënë se anëtarësimi në licencën CEMENT do t’ua lehtësonte transportin dhe do t’i ulte kostot e operimit. Ndërsa Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) e ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm anëtarësimin e vendit tonë në çdo organizatë ndërkombëtare, përfshirë edhe CEMENT-in, kurse nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) për “Kosovapress”, kanë thënë se janë në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Punëve të Jashtme

dhe Diasporës (MPJD) dhe po llobojnë përmes kanaleve diplomatike te vendet mike për ta siguruar përkrahjen e nevojshme. Qëllimi, sipas tyre, është që pas dorëzimit të aplikimit zyrtar, Kosova t’i ketë votat e mjaftueshme për anëtarësim në CEMENT. CEMENT-i, ndër të tjera, lëshon leje ndërkombëtare për transportin rrugor të mallrave. Konferenca Evropiane e Ministrave të Transportit (e njohur gjithashtu si Forumi Ndërkombëtar i Transportit) është një organizatë ndërkombëtare e përqendruar në politikat dhe infrastrukturën e transportit, veçanërisht përmes lejeve shumëpalëshe CEMENT që lehtësojnë transportin ndërkufitar të mallrave në Evropë. Shembull, me lejen e CEMENT-it mund të lejohet transporti i mallrave me rrugë ndërmjet vendeve anëtare pa pasur nevojë për autorizime të veçanta për çdo udhëtim, çka lehtëson transportin ndërkufitar të mallrave, duke e bërë atë edhe më efikas. Kryetari i Shoqatës së Transportit të Mallrave të Kosovës, Muhamet Thaçi, ka thënë se Kosova është dashur të jetë prej kohësh anëtare e CEMENT-it, pasi kjo do t’i vendoste transportuesit kosovarë në pozitë të barabartë me ata të rajonit dhe të Evropës. Ai ka theksuar se shoqata që ai drejton do të angazhohet për këtë proces në bashkëpunim me Qeverinë e



Kosovës. Sipas Thaçit, anëtarësimi në CEMENT do të kishte ndikim të drejtpërdrejtë në lehtësimin e punës së transportuesve, duke mundësuar qarkullim më të shpejtë të mallrave dhe zvogëlim të kostove të transportit. Ai ka shtuar se përmes kësaj leje, kompanitë vendore do të kishin mundësi të kryejnë transport në destinacione të ndryshme në Evropë, pa pengesa administrative që aktualisht i ngadalësojnë. “Kosova është dashur të jetë anëtare e CEMENT-it. Duhet të bëhet patjetër për arsye se të bëhemi të barabartë transportuesit e Kosovës me ata të rajonit dhe të Evropës. Ne si shoqatë do të angazhohemi rreth anëtarësimit në bashkëpunim me Qeverinë e Kosovës. Sa i përket anëtarësimit në CEMENT do të na lehtësonte punët e transportit në Evropë dhe rajon pasi të gjitha vendet që na rrethojnë janë të anëtarësuara në CEMENT. Pastaj mund të bëjmë transport, të shkarkojmë në vende dhe destinacione të ndryshme në Evropë dhe gjetiu. Anëtarësimi në CEMENT do të ndikonte në shpejtësinë e transportit që mund ta bëjë në vendet e caktuara dhe

kur të lehtësohet, lehtësohen edhe shpenzimet për transport”, ka thënë Thaçi. Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Lulzim Rafuna, ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në CEMENT dhe në organizata të tjera ndërkombëtare është thelbësor për përmbushjen e standardeve dhe përshtatjen me zhvillimet e reja globale. Ai ka theksuar se transportuesit kosovarë përballen me pengesa të shumta burokratike që u pamundësojnë depërtimin në tregjet rajonale ndërsa, sipas tij, kompanitë e huaja po marrin tregun. Sipas Rafunes, përveç anëtarësimeve ndërkombëtare, nevojiten edhe reforma të brendshme në Ministrinë e Infrastrukturës për të fuqizuar sektorin e transportit. Lidhur me anëtarësimin në CEMENT, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) në një përgjigje me shkrim për “Kosovapress”, kanë thënë se kanë parashtruar kërkesën zyrtare te Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës (MPJD) dhe po ndjekin hapat proceduralë për t’u bërë anëtare e këtij mekanizmi ndërkombëtar. Kjo ministri ka theksuar se koordinimi i ngushtë me MPJD-në është i domosdoshëm për ta përgatitur aplikimin formal. “MMPHI-ja ka parashtruar kërkesën zyrtare te MPJD-ja për ta proceduar tutje kërkesën tonë për anëtarësim në ECMT, megjithatë

duhet të kemi parasysh faktin se për t’u anëtarësuar zyrtarisht në këtë mekanizëm duhen ndjekur disa hapa proceduralë paraprakë për të arritur deri te parashtrimi i kërkesës formale te ky mekanizëm. MMPHI-ja është në koordinim të ngushtë me MPJD-në për veprimet që duhen ndjekur në raport me kërkesën për anëtarësim. Në këtë kuptim duhet cekur faktin se jemi duke lobuar përmes kanaleve diplomatike te vendet mike që janë anëtare në këtë mekanizëm, po ashtu edhe në takimet bilaterale që kemi në kuadër të komisioneve teknike të përbashkëta me vendet respektive për zbatimin dhe mbikëqyrjen e marrëveshjeve bilaterale, për ta arritur përkrahjen maksimale të vendeve anëtare, në mënyrë që sapo të dorëzohet zyrtarisht aplikimi te sekretariati i ECMT-së, t’i kemi votat e mjaftueshme për pranim, respektivisht anëtarësim”, ka njoftuar MMPHI-ja. Një listë jopërfundimtare e shteteve anëtare në CEMENT përfshinë Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Bosnjë-Hercegovinën, Serbinë, Kroacinë, Slloveninë, Greqinë, Italinë, Austrinë, Gjermaninë, Francën, Zvicrën, Hungarinë, Bullgarinë, Rumaninë, Poloninë, Çekinë, Sllovakinë, Turqinë, Mbretërinë e Bashkuar (Britania), Spanjën, Portugalinë, Danimarkën, Suedinë, Finlandën, Norvegjinë, Holandën, Belgjikën, Luksemburgun e shumë shtete të tjera botërore.

Shqipëria synon të ofrojë ID digjitale në fillim të vitit 2026

TIJANË, 20 TETOR - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka bërë me dije se projekti i identitetit digjital do të jetë gati për publikun në fillim të vitit të ardhshëm. Këtë deklaratë Rama e ka bërë gjatë pjesëmarrjes në aktivitetin e prezantimit të identitetit digjital, një projekt që, sipas tij, do ta vendosë qytetarin në qendër të marrëdhënies me shtetin

përmes teknologjisë. “Një tjetër moment i shumëpritur dhe mirëpritur, sepse prej disa kohësh jemi angazhuar me shumë dëshirë dhe ambicie për ta krijuar identitetin digjital”, ka thënë Rama. Kryeministri Rama ka theksuar se sistemi do të jetë gati për të gjithë qytetarët në fillim të vitit të ardhshëm. “Çfarë po demonstrohet sot

do të jetë në dispozicion të publikut dhe të raportit mes qytetarit, shtetit dhe ekonomisë sonë në fillim të vitit të ardhshëm”, ka thënë kryeministri Rama. Rama është ndalur edhe te krahasimi me Bashkimin Evropian, duke theksuar se Shqipëria po ecën me ritëm të shpejtë në këtë drejtim. “BE-ja po përgatitet për identitetin digjital dhe objektivi i

shpallur është që në vitin 2027 qytetarët e BE-së të mund të pajisen me identitetin e tyre digjital. Ne do të jemi një hap më para”, është shprehur Rama. Kryeministri e ka quajtur këtë nismë “një bekim të kohës moderne”, duke theksuar se teknologjia digjitale po i mundëson Shqipërisë të kapërcejë pengesa historike në shërbime publike.




GRABITJA E PABESUESHME NË MUZEUN E LUVRIT DHE HISTORIA E ‘NJERIUT QË VODHI MONA LIZËN’

Aktori Alessandro Preziosi në një foto skene duke luajtur Vincenzo Peruggia, protagonistin e filmit të Fabrizio Costa "Njeriu që vodhi Mona Lizën"

Vjedhje e pabesueshme në Muzeun e Luvrit në Paris. Siç raportohet nga Le Parisien, hajdutët vodhën nëntë bizhuteri nga koleksioni i Napoleonit dhe Perandoreshës: një gjerdan, një brosh, një diademë dhe më shumë (ja sa vlen plaçka në tregun e zi). Dy janë rikuperuar. Menjëherë pas vjedhjes, ndërtesa u evakuua dhe u mbyll menjëherë për publikun "për arsye të jashtëzakonshme", sipas një mesazhi të publikuar nga muzeu në X. Por kjo nuk është grabitja e parë në Muzeun e Luvrit.

Grabitja e famshme e vitit 1911

Natën midis 21 dhe 22 gushtit 1911, Luvri u mbyll për mirëmbajtje. Një burrë, i veshur si punëtor, hyri në Salon Carré, ku ishte ekspozuar portreti më i famshëm në botë. Disa orë më vonë, Mona Lisa e Leonardo da Vincit u zhduk. Ishte fillimi i vjedhjes më të famshme në historinë e artit. Pas grabitjes qëndronte Vincenzo Peruggia, një piktor shtëpish nga Dumenza, në provincën e Vareses, i cili doli me kryeveprën e fshehur nën pallton e tij. I bindur - gabimisht - se piktura ishte vjedhur nga Napoleoni dhe i vendosur ta "kthente atë në Itali", ai hartoi një plan aq të thjeshtë sa edhe të guximshëm:



duke punuar për kompaninë përgjegjëse për mirëmbajtjen e muzeut, ai i dinte zakonet dhe masat e sigurisë së stafit. Atë ditë, ai e hoqi panelin nga korniza e tij, e fshehu nën pallton e tij dhe u zhduk i pashqetësuar.

Vincenzo Peruggia, një dekorues dhe piktor shtëpish, emigroi në Francë në një moshë shumë të re dhe pati mundësinë të punonte në Luvër dhe të merrte pjesë në rinovimin e vitrinës së xhamit ku ndodhej Mona Lisa, e cila atëherë ndodhej në Salon Carré. Prandaj, ai e njohte shumë mirë vendndodhjen dhe zakonet e stafit të muzeut. Dhe vjedhja e Mona Lisës dhe sjellja e saj në Itali ishte lojë fëmijësh për të. Ajo natë e së dielës ishte nata para ditës së zakonshme të mbylljes së Luvrit, dhe Peruggia,

piktor, po flinte i qetë në dollap, duke pritur orën shtatë të mëngjesit. Kur, pasi rojet u çlodhën, ai e hoqi lehtësisht pikturën nga korniza e saj dhe e futi nën pallto.

Ai e kishte vendosur vetë në kuti pak kohë më parë dhe dinte çfarë të bënte. Pastaj, me qetësi, u drejtua drejt daljes dhe i kërkoi një hidrauliku t'ia hapte derën. Në një çast, ai u gjend në Rue de Rivoli dhe pak më pas në një taksi të rehatshme. Ishte ora 8:30 e mëngjesit. Masat e vetme të sigurisë në fuqi në atë kohë përbëheshin nga roje të stërvitura në xhudo. Dhe vjedhja nga Luvri ishte një risi e plotë. Zhdukja u zbulua vetëm të nesërmen. Kërkimi, në fakt, ishte i ngadaltë dhe u krye me vështirësi. Në fillim, njerëzit menduan se ishte një gabim në

inventar ose një vepër e paregjistruar. Pastaj mosbesimi ia la vendin provave: Mona Lisa ishte vjedhur. Hetimi, i cili zgjati për më shumë se dy vjet, implikoi gjithashtu figura kryesore të avangardës kulturore si poeti Guillaume Apollinaire dhe Pablo Picasso, të dy të dyshuar dhe më vonë të liruar nga akuzat.

Në dhjetor të vitit 1913, Peruggia kontaktoi tregtarin florentin të antikiteteve Alfredo Geri, duke i ofruar ta shiste pikturën me kusht që ajo të mbetej në vend. Më 11 dhjetor, Geri dhe drejtori i Uffizi-t, Giovanni Poggi, shkuan në dhomën e hotelit ku ishte fshehur piktura. Ata menjëherë e njohën autenticitetin e veprës dhe njoftuan policinë, e cila siguroi pikturën dhe arrestoi Peruggian, i cili do të mbetej në

histori si "hajduti i Mona Lisës". Hajduti gjithmonë pohonte se e kishte vjedhur pikturën e Leonardos vetëm për ta kthyer atë në vendin e tij. Piktori italian nuk ishte në dijeni se Mona Lisa ka qenë gjithmonë, dhe me të drejtë, franceze, pasi ishte shitur për 4,000 dukatë te Francis I nga vetë Leonardo da Vinci. Pas rikuperimit të saj, kryevepra e Leonardos u ekspozua përkohësisht në Uffizi dhe muze të tjerë italianë, përpara se të kthehej në Luvër në janar 1914, e përsëritur nga një turmë entuziaste.

Jo vetëm vjedhja e Perugia-s

Ky incident nuk është i vetmi në historinë e vjedhjeve në muzeun parizien, i cili sot strehon mbi 33,000 kryevepra që variojnë nga antikiteti, skulptura dhe piktura, nga Mesopotamia, Egjipti dhe bota klasike deri te mjeshttrat evropianë. Ndër veprat kryesore të tij janë Mona Lisa, Venusi i Milos dhe Fitorja me Krahë e Samotrakës. Galeria d'Apollon, ku ndodhi vjedhja e fundit, shfaq një përzgjedhje të Xhevahireve të Kurorës Franceze.

Në vitin 1983, dy kostume armaturash të Rilindjes u vodhën dhe u gjetën vetëm dyzet vjet më vonë. Dhe vetë Luvri mban ende shenjat e plaçkitjes së Napoleonit, të cilat vazhdojnë të nxisin debatin mbi kthimin e veprave të artit. /Liberale.al/

KUR MIRËSIA BËHET MIZORE

Si është e mundur? Çfarë mund të ketë të keqe tek të qenit i mirë? Shpjegimi sipas Frank Herbertit

Të gjithë e dimë shprehjen: "Bëju të tjerëve atë që do të doje të të bënin ty."

Shumë përpiqen ta ndjekin këtë rregull të artë, jo vetëm sepse është i drejtë, por sepse është gjë e mirë.

Por pastaj, dikush si Frank Herbert – shkrimtar e mendimtar – thotë diçka që na trondit: mirësia mund të jetë mizore.

Si është e mundur? Çfarë mund të ketë të keqe tek të qenit i mirë?

Nga këndvështrimi gjuhësor, "mirësi" dhe "mizori" janë të kundërta, si dy pole magnetike. Mirësia nënkupton ndihmë, dashamirësi, bujari. Mizoria, përkundrazi, nënkupton ftohtësi, shpërfillje, apo edhe

dëshirën për t'i shkaktuar tjetrit dhimbje. E megjithatë, ka raste kur njëra mund të çojë në tjetrën.

Mjafton të kujtojmë vargun biblik: "Zoti jep dhe Zoti merr." Apo ta zbrisim këtë në tokë: "Qeveria jep dhe qeveria merr." Popujt autoktonë të Kanadasë e kanë përshkruar më mirë se kushdo këtë paradoks. Ata thonë: "Na dhanë toka, shkolla dhe përfitime, por na morën krenarinë, dinjitetin dhe shpirtin." Një akt mirësie që u shndërrua në plagë.

E njëjta gjë ka ndodhur shpesh me sistemet e ndihmës sociale: paratë që jepen për të ndihmuar, ndonjëherë ua marrin njerëzve dëshirën dhe mundësinë për të përballuar vetë jetesën.

Një gjest bujarie që, pa dashje,

kthehet në varësi — pra në një formë tjetër mizorie.


Sepse të ndihmosh dikë pa e fuqizuar, është si t'i marrësh lirinë me duart e tua.

Mirësia ka shumë fytyra: dhembshuri, butësi, zemërgjerësi, altruizëm. Por secila prej tyre mund të humbasë kuptimin nëse shndërrohet në një mënyrë për të ndier veten mirë, apo për të marrë diçka në këmbim.

Mirësia e vërtetë nuk është ndjesi, por vetëdije. Nuk është akt për të ndier keqardhje, por për të kuptuar se si ndihma jonë ndikon tek tjetri.

Shpesh edhe pa qëllim të keq, mirësia mund të keqkuptohet. "Më lëndove ndjenjat — pse e bërë këtë?"

Ndoshta synimi ishte i mirë, por mënyra e shprehjes e



prishi mesazhin. Mirësia që nuk matet me kujdes mund të perceptohet si arrogancë, mëshirë e tepruar, apo edhe fyerje.

Në fund, mirësia e singertë lind mirësinë, por mund të

lindë edhe zemërim, zhgënjim, madje mizori – nëse nuk ushqehet me vetëdije, maturi dhe ndershmëri.

Sepse, po, edhe mirësia, kur bëhet pa menduar, mund të bëhet mizore. / bota.al

LUFTËRAT HAPËSINORE

A mund ta devijojmë një asteroid që të mos godasë Tokën? Suksesi i misionit DART të NASA-s sugjeron se po, por vetëm pasi misioni HERA i ESA-s — tashmë në fazë nisjeje — të verifikojë rezultatet, do të dimë nëse jemi vërtet në gjendje ta mbrojmë planetin nga ky kërcënim

Viti 2023: gati 200 raketa hapësinore u ngritën nga pika të ndryshme të Tokës për të çuar në orbitë satelitë dhe mjete të tjera hapësinore. Viti 2024: numri u rrit në gati 250, shumica nga SpaceX e Elon Musk. Mes gjithë këtyre lëshimeve, të kryera në indiferencë pothuaj të plotë të mediave tradicionale, pati një më 7 tetor që mund të rezultojë ndër më të rëndësishmit ndonjëherë: misioni HERA i Agjencisë Hapësinore Evropiane (ESA), që ka për qëllim të na tregojë nëse dhe sa jemi të aftë të devijojmë trajektoren e një asteroidi. Në nëntor 2021, NASA nisi misionin Double Asteroid Redirection Test (DART). Objektivi ishte Dimorphos, një shkëmb i vogël 177 m në diametër që rrotullohet rreth një asteroidi më të madh, Didymos. Sonda DART do të përplasej qëllimisht me Dimorphos për të parë nëse mund të ndryshonte orbitën e tij. Misioni u konceptua për të testuar një teknikë devijimi të quajtur impaktues kinetik (me pak fjalë, ta përplasësh një gjë me një tjetër) – dhe ia doli. Sonda goditi shënjestrën me shpejtësi rreth 6,6 km/s në shtator 2022, duke e ndryshuar kohën e orbitës së saj rreth Didymos me 33 minuta, shumë më tepër sesa pritej. Ishte një moment historik: hera e parë që ne ndryshuam me qëllim trajektoren e një trupi qiellor. “DART tregoi sa efektiv mund të jetë një impaktues kinetik për të lëvizur dhe devijuar asteroidet e vegjël. Ishte një mision me sukses të madh”, thotë prof. Alan Fitzsimmons, astronom në Queen’s University Belfast, Irlandë e Veriut, i specializuar në kërkimet për asteroidet. Që të interpretohet si duhet suksesi i NASA-s, astronomët duhet të mbledhin një sërë të dhënash kyçe për objektivin: për shembull, struktura e brendshme e Dimorphos dhe si reagoi ndaj goditjes. Këtu hyn në lojë HERA. Duke mbërritur në sistemin Didymos–Dimorphos në 2026, HERA do të kryejë një investigim të detajuar pas-impaktit të dy asteroideve: do të kapë imazhe me rezolucion të lartë, do të masë masat e asteroideve dhe do të studiojë pasojat e goditjes së DART-it.

Sonda hapësinore HERA

Sa madhësia e një automjeti dhe peshë 1,2 ton, HERA mbart pesë instrumente shkencore për të mbledhur të dhënat e

nevojshme për ta karakterizuar Dimorphos-in: dy kamera (një në dritë të dukshme, një në infra të kuqe); një imazher hiperspektral për të ndarë dritën në breza të vegjël për analiza gjeologjike e përbërëse; një altimetër lazer për të matur distancën e HERA-s nga sipërfaqja e asteroidit; dhe një eksperiment radioshkencor për të përcaktuar masat dhe fushat gravitacionale të asteroideve. Ndërtimi i saj përfshiu 18 vende dhe kontributi italian ishte i rëndësishëm, si shkencërisht, ashtu edhe industrialisht. INAF projekttoi instrumentin VISTA për të studiuar grimcat e pluhurit, ndërsa Universiteti i Bolonjës merr pjesë me një projekt radioshencor. Kompani italiane si Thales Alenia Space, Leonardo, OHB Italia, Avio dhe TSD Space ofruan komponentë thelbësorë.

HERA do të vendosë gjithashtu dy CubeSat (nanosatelitë) për hetime shtesë. Njëri, i ndërtuar nga Tyvak International në Torino, quhet Milani në nder të prof. Andrea Milani, pionier i monitorimit të rreziqeve nga asteroidet, dhe do të lejojë zbulimin e mineralogjisë së sipërfaqes. Tjetri, Juventas, mbart një radar që do t’u mundësojë shkencëtarëve të “shohin brenda” asteroideve për të përcaktuar strukturën dhe përbërjen e tyre të brendshme. Së bashku, të dhënat do të jenë thelbësore për të kuptuar teknikat e devijimit dhe përdorimet e tyre të mundshme në mbrojtjen planetare në të ardhmen. Asteroidet, në fakt, mund të jenë të dy tipeve: monolitikë ose “rubble pile” (grumbull rrënojash). Të parët janë blloqe të vetme shkëmbore dikur të shkrira; të dytët janë konglomerate mbetjesh pa një strukturë solide. Secili do të reagojë ndryshe ndaj një impaktuesi kinetik. Mendohet se Dimorphos i përket llojit të dytë. “Kur të marrim imazhet e para nga HERA, në fund të 2026, do ta kuptojmë shpejt si është strukturuar brenda Dimorphos, si reagon dhe cilat janë veçoritë e tij fizike,” thotë Fitzsimmons.

Përpyqje globale

Në 20 vitet e fundit, mbrojtja planetare është bërë një prej objektivave kryesorë të agjencive hapësinore në mbarë botën, dëshmi e ndërgjegjësimit në rritje për kërcënimin nga asteroidet. Përveç NASA-s dhe ESA-s, edhe Kina po punon për një test devijimi me një mision ende pa emër, parashikuar për 2027.



Objektivi i mundshëm është asteroidi 2015 XF261, një shkëmb i vogël 17–78 m i gjerë. “Kina synon të kombinojë DART dhe HERA në një nisje të vetme me dy sonda: njëra do të përplasë me asteroidin, tjetra, në një trajektore tjetër, do të bëjë vëzhgimet pasuese,” shpjegon Andrew Jones, gazetar i specializuar në industrinë hapësinore kineze. Ndryshe nga ç’ndodhi me DART dhe HERA, sonda vëzhguese kineze do të mbërrinte së pari, do të studionte asteroidin për muaj me radhë, do të transmetonte impaktin në kohë reale dhe do të analizonte menjëherë pasojat. Përveç përparimit në metodat për të mbrojtur Tokën, këto misione ofrojnë edhe fitime shkencore: asteroidet janë mbetje të hershme të Sistemit Diellor dhe mbartin gjurmë kyçe për formimin e planeteve.

Sistemi parandalues i alarmimit


Edhe pse testet e devijimit marrin vëmendjen e mediave të gjera, themelet e mbrojtjes planetare janë zbulimi dhe gjurmimi. Prandaj ekzistojnë struktura ndërkombëtare që gjeolokalizojnë orbitat e asteroideve të njohur dhe zbulojnë të panjohur. Planetary Defense Coordination Office (PDCO) i NASA-s dhe International Asteroid Warning Network (IAWN) përdorin teleskopë të fuqishëm dhe radarë tokësorë për të skanuar vazhdimisht qiellin për objekte që mund t’i afrohen rrezikshëm Tokës. Dhjetëra struktura në botë kontribuojnë, dhe dy spikasin veçanërisht: Pan-

STARRS në Observatorin e Haleakalā (Maui, Hawai) dhe Catalina Sky Survey (CSS) në malet Santa Catalina (Arizona, SHBA). Së bashku kanë zbuluar mbi 17.000 NEO (objekte pranë Tokës). Një arritje e rëndësishme e CSS ishte zbulimi i asteroidit 2024 RW1, një shkëmb 1 m i gjerë, i detektuar më 4 shtator 2024. ESA analizoi menjëherë të dhënat dhe kuptoi se po drejtohej nga Toka, duke postuar në X (ish-Twitter): “Një asteroid rreth 1 m do të hyjë në atmosferën tokësore mbi Filipine, pranë ishullit Luzon, në 17:08 UTC sot, 4 shtator. Objekti është i padëmshëm, por njerëzit në zonë mund të shohin një top zjarri spektakolar! I zbuluar në mëngjes nga Catalina Sky Survey, ky është vetëm i nënti asteroid që njerëzimi e ka identifikuar para impaktit.” Dhe vërtet, shkëmbi u shpërbë duke prodhuar një meteorit shumë të ndritshëm, të filmuar nga shumë kamera. Edhe pse koha mes zbulimit dhe hyrjes në atmosferë ishte rreth tetë orë, sipas prof. Fitzsimmons kjo tregon përparimin në parashikimin e impakteve: “E rëndësishmja është që u identifikua; orbita u llogarit, u ndoq dhe e dinim që do të godiste; koha dhe vendi i impaktit u përcaktuan me saktësi të madhe përpara se të hynte në atmosferë. 20–30 vjet më parë, kjo s’do të ishte e mundur.” Me fjalë të tjera, zbulimi me teleskopë dhe llogaritjet pasuese tani janë mjaft të ndjeshme e të shpejta për të parashikuar impakte. Nëse mund ta bëjmë këtë për një “guralec” 1 m të gjerë, i gjetur

vetëm disa orë para hyrjes, duhet të jemi në gjendje të zbulojmë objekte 50 m një javë më herët, ose shkëmbinjtë sa Dimorphos rreth një muaj (ose më shumë) përpara goditjes. Ky është një aspekt vendimtar: sa më herët zbulon një asteroid, aq më e vogël forca e nevojshme për ta shtyrë në një trajektore jo kërcënuese.

Sytë nga qielli

Për të rritur kapacitetin e zbulimit të NEO-ve, po ndërtohen struktura të reja. ESA po punon për një teleskop tokësor të quajtur Flyeye, frymëzuar nga sytë e përbërë të insekteve, që do të vëzhgojë një sipërfaqe shumë të gjerë të qiellit në një të vetme. Ai do të ndërtohet në Sicili, në majë të Monte Mufara (provinca Palermo), 1865 m mbi nivelin e detit. Në 2025 pritet të hyjë në punë Observatori Vera C. Rubin në Cerro Pachón, Kili. Me një teleskop gjurmimi 8,4 m në diametër, pritet të jetë një burim i jashtëzakonshëm për zbulimin e NEO-ve. Janë planifikuar edhe disa teleskopë hapësinorë. NASA po financon NEO Surveyor, me lançim rreth 2027–28. Me aperturë 50 cm, është projektuar të zbulojë e klasifikojë shumicën e asteroideve dhe kometave potencialisht të rrezikshme brenda 30 milionë miljeve nga orbita e Tokës. Duke punuar në dy gjatësi vale infra të kuqe, do të japë vlerësime të mira të madhësisë së shkëmbinjve, si dhe të dhëna për përbërjen, formën dhe shpejtësinë e rrotullimit. / bota.al



Almir Kryeziu, “Ylli i Javës” në Superligë

PRISHTINË, 20 TETOR - Futbollisti i FC Ballkanit, Almir Kryeziu, është shpallur “Ylli i Javës” për javën e nëntë të Superligës së Kosovës në futboll. Federata e Futbollit e Kosovës (FFK), në bashkëpunim me sponsorin zyrtar të Superligës, Albi Mall, ka ndarë çmimin tradicional që i dedikohet futbollistit më të

dalluar të javës. Kryeziu është vlerësuar për paraqitjen e tij të shkëlqyer në ndeshjen kundër KF Dukagjinit, ku shënoi dy gola të vetëm në fitoren 2:0, duke i siguruar Ballkanit tri pikë të rëndësishme në garën për titull. Vlerësimi është bërë nga Komisioni i Veteranëve të

Futbollit. Pas marrjes së çmimit, Kryeziu është shprehur i lumtur për këtë vlerësim. “Ka qenë një ndeshje e vështirë, por pushimi që e kishim për ndeshjet e Kombëtares na ka ndihmuar të punojmë dhe të analizojmë mirë kundërshtarin. Jam i lumtur, në aspektin individual, që kam

shënuar dy gola dhe që po arrij ta ndihmoj ekipin. I falënderoj bashkëlojtarët dhe shtabin teknik për besimin dhe bashkëpunimin. Synimet e Ballkanit, si gjithmonë, janë kreu i tabelës dhe besojmë që me punë do ta arrijmë objektivin tone”, ka thënë ai për faqen zyrtare të FFK-së.



PRISHTINA VAZHDON SERINË E FITOREVE, BALLKANI RIKTHEHET TE FITORJA

PRISHTINË, 20 TETOR - Xhiroja e nëntë e AlbiMall Superligës së Kosovës ka sjellë ndeshje mjaft interesante dhe plot gola. Drita e ka vazhduar formën pozitive në AlbiMall Superligën e Kosovës, duke shënuar fitoren e tretë radhazi, ndërsa Debatik Curri ka debutuar me sukses në drejtim të Gjilanit. Kampionia në fuqi, Drita, ka triumfuar në shtëpi ndaj Malishevës me rezultat 2:1. Ndërsa Gjilani ka shënuar fitore të vlefshme në udhëtim ndaj Prishtinës së Re, me rezultat minimal 1:0, në stadiumin “Sami Kelmendi” në Lipjan. Kjo ishte ndeshja e parë për trajnerin e ri të kuqebardhëve, Debatik Curri, i cili ka debutuar me fitore në bankinën e skuadrës gjilanase,

kurse kryesuesja e liderja e AlbiMall Superligës, Prishtina, ka shënuar fitore dramatike ndaj Drenicës me rezultat 4:3 në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “Bajram Aliu” në Skenderaj. Në kuadër të xhiros së nëntë të AlbiMall Superligës, skuadra e Ballkanit është rikthyer te fitorja pas disfatës në Prishtinë xhiron e kaluar, duke e mposhtur Dukagjinin me rezultat 2:0 në ndeshjen e luajtur në Suharekë. Në Podujevë, Llapi është ndalur me barazim 1:1 nga Ferizaj, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin “Zahir Pajaziti”. Pas xhiros së nëntë, Prishtina kryeson me 22 pikë, e ndjekur nga Ballkani me 18, Dukagjini e

Drita me 14. Në mesin e tabelës janë Drenica, me 11 pikë e Llapi që mban pozitën e gjashtë me 10 pikë, sa kanë edhe Malisheva, Gjilani dhe Ferizaj, ndërsa në fund renditet Prishtina e Re me 7 pikë.

RENDITJA E EKIPEVE PAS XHIROS SË NËNTË:

Prishtina	22
Ballkani	18
Dukagjini	14
Drita	14
Drenica	11
Llapi	10
Malisheva	10
Gjilani	10
Ferizaj	10
Prishtina e Re	7



10 GOLA NË 9 NDESHJE NË LA LIGA, VETËM RONALDO KA BËRË MË MIRË SE MBAPPE TE REALI



MADRID, 20 TETOR - Kylian Mbappe është duke dominuar në fillim të sezonit te Real Madridi. Sulmuesi francez të dielën mbrëma e ka shënuar golin e fitores kundër Getafes (1:0) duke arritur në kuotën e 10 golave në vetëm 9 ndeshje të këtij sezoni në La Liga. I shërbyer në mënyrë të përkryer nga Arda Guler, kapiteni i “Bleus” e ka finalizuar mjaft mirë këtë aksion duke ia siguruar tri pikë mjaft të rëndësishme

Realit dhe duke e dërguar ekipin në krye të renditjes. Me këtë arritje, Mbappe është bërë lojtari i parë i Realit që e arrin shifrën dyshifrore aq shpejt që nga koha e Cristiano Ronaldos, kur në sezonin 2014/15 portugezi i kishte shënuar 17 gola në këtë pikë të sezonit. Ronaldo në atë vit e kishte mbyllur sezonin në La Liga me 48 gola në total, një shifër që do të jetë e vështirë të arrihet nga

Mbappe, por që futbollit nuk i dihet kurrë. Përpos statistikave në kampionat, ish-futbollisti i Monacos dhe Paris Saint-Germainit është duke ofruar paraqitje të nivelit të lartë në të gjitha kompeticionet. Ka shënuar në 11 ndeshjet e fundit në mes të Real Madridit dhe Kombëtares franceze, duke e përjashtuar vetëm lojën me Mallorcën në fund të gushtit, kur nuk kishte arritur ta gjente golin. Nëse e

vazhdon këtë ritëm, Mbappe mund t’u afrohet standardeve të Cristiano Ronaldos dhe Lionel Messit në nivelet e tyre më të larta. Vazhdimësia dhe kapaciteti për të shpërthyer në momentet vendimtare po e konfirmojnë rolin e tij të liderit teknik dhe të simbolit të Real Madridit, i cili, falë golave dhe vetëbesimit, po shikon me siguri drejt objektivave të ardhshme në La Liga dhe në Ligën e Kampionëve.

Graham Potter, selektor i ri i Suedisë

STOKHOLM, 20 TETOR - Anglezi Graham Potter është selektor i ri i Kombëtares së Suedisë, duke e zëvendësuar në këtë pozitë danezin Jon Dahl Tommasson të shkarkuar javën e shkuar. Potter të hënën është zyrtarizuar nga Federata e Futbollit e Suedisë, e cila ka

reaguar menjëherë pas humbjes nga Kosova në Goteborg duke e larguar Tommassonin. Potter është angazhuar me një marrëveshje që përfshinë dy ndeshjet e fundit të kualifikimeve për Kupën e Botës 2026, me një fazë

eliminatore të mundshme në mars, dhe një zgjatje automatike për Botëror nëse Suedia kualifikohet. 50-vjeçari Potter së fundmi ishte trajner i West Ham Unitedit, kurse ka udhëhequr edhe Chelsea, Brightonin e Swansea, ndërsa në Suedi

për shtatë vjet ka qenë trajner i Ostersundit. Muajin tjetër Suedia përballët me Zvicrën dhe Slloveninë në dy ndeshjet e fundit të Grupit B kualifikues, në të cilin zë vendin e fundit me vetëm 1 pikë pas katër dueleve të luajtura.





BAZUAR NË THIRRJEN PËR APLIKIM PËR MASA 5 ZBATIMI I STRATEGJIVE ZHVILLIMORE LOKALE – QASJA LEADER PËR GRUPET LOKALE TË VEPRIMIT (GLV- të) të PËRZGJEDHURA

NGA MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL – AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË

GRUPI LOKAL I VEPRIMIT- VITIA- SHPALL:

KONKURS

PËR PRANIMIN E MENAXHERIT TË GLV-së – VITIA-

Fushëveprimtaria e punës:

- 1.Njohja me LEADER
- 2.Zbatimi i kriterëve të LEADER-it
3. Identifikimin / Zhvillimin e projektit në pajtim me Strategjinë Zhvillimore Lokale (SZHL)
4. Bashkëpunues me strukturat lokale
5. Eksperiencë në menaxhimin e projekteve
6. Aftësi në organizimin e trajnimeve
7. Raporte mujore për aktivitetet e kryera
8. Një raport përfundimtar me rezultatet e arritura

Profili:

1. Diplomë Universitare
2. CV – në
3. Njohës i mire i gjuhës angleze
4. Përparësi – Fakulteti i Bujqësisë ,Ekonomisë , Menaxhimit, Agroekonomisë etj.
5. Përvojë profesionale në zhvillimin e projekteve lidhur me bujqësi dhe zhvillim rural është i mirëseardhur
6. Trajnim i veçantë në fushën e zhvillimit lokal apo të qëndrueshëm do të ishte përparësi

Aftësitë:

1. Aftësi në komunikim
2. Të jetë motivues
3. Menaxher i burimeve dhe informatave
4. Aftësi për hartimin e planit të veprimit
5. Të ketë aftësi për partneritet
6. Të jetë promovues
7. Të mbështesë aktivitetet e Rrjetit
8. Të jetë kërkuar i burimeve të tjera

Dokumentet për aplikim:

- Dëshmia për përgatitjen profesionale / Diploma
- Të dhënat personale / CV për kandidatin
- Letër motivimi
- Vërtetim që nuk është nën hetime
- Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës
- Certifikata e lindjes
- Referencë
- Leje valide të vozitjes. Automjet personal për qëllime të punës do të ishte përparësi

Aplikacionet dorëzohen në zyrën e Grupit Lokal të Veprimit , kati i dytë, nr. 4 – në objektin e Shtëpisë së Kulturës “ Gursel e Bajram Sylejmani” – në Viti- nga ora 9^h – 15^h ,ose në email adresën : glv_viti@hotmail.com


Afati i aplikimit është 7 (shtatë) ditë nga dita e shpalljes në media.

Afati i kontratës zgjatë një vit, orari është 4 (katër) orë në ditë, paga mujore 350 € bruto.

VITI

Më: 21.10.2025

Kryetaria e GLV-së



Fadile Demelezi



Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania kompanisë “Weng Fat Poultry” shpk, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, – për “Fabrikën e përpunimit të mishit të shpezëve”, në Z.K. Polac, Skenderaj.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 18.11.2025 në ora 10:00 në Objektin e Sh.F.M.U "Drenica" ne Polac, do të organizohet debat publik nga Kompania kompanisë “Weng Fat Poultry” Shpk, Skenderaj, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/9072254231?pwd=QjhTUE1yMVFCbTBRL3laU2xEQkx0Zz09>

Meeting ID: 907 225 4231

Passcode: N3hASu

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë kompanisë “Weng Fat Poultry” shpk, Skenderaj, për Pëlqim Mjedisor, – për “Fabrikën e përpunimit të mishit të shpezëve”, në Z.K. Polac, Skenderaj.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

<vnm.komente@rks-gov.net>

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Njoftim për Zvogëlim të Kapitalit Themelor

Në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Virtus Auto” Sh.P.K., me seli në Prishtinë, rr. Nënë Tereza, Zona Industriale PN, e regjistruar në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës me numër unik identifikues (NUI) 811557480, njofton publikun dhe kreditorët se ka marrë vendim për zvogëlim të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar i shoqërisë zvogëlohet nga shuma katërqind mijë (400,000.00) euro në shumën dyqind mijë (200,000.00) euro, sipas Vendimit të datës 28 gusht 2025.

Të gjithë kreditorët e shoqërisë ftohen që, brenda afatit ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga publikimi i këtij njoftimi, të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim në adresën e shoqërisë ose përmes emailit zyrtar të saj.

Data: 28.08.2025

Virtus Auto SH.P.K.

(Prishtinë, rr. Nënë Tereza, Zona Industriale PN)

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Irfan Hodaj shpall te pa vlefshme dëftesën e shkollës fillore “Luigj Gurakuqi” në Nashec.

- Blerim Gashi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Profesionale Teknike “Gani Qfderbasha” Prizren.

- Samile Mullaibrahimi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m të mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- Muharrem Shala shpall të pavlefshme diplomën si dhe dëftesat e shkollës fillore “Mustafa Bakija”.

- Albatros Manxhuka shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Nikoll Kazazi”.

- Shqiprim Morina shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “12 Maji”.

- “Fire Protection Agency Rifiel Action” LLC. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.

- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

